



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr. 6871 Prot

Tiranë, më 11 / 07 / 2017

URDHËR

Nr. 361 datë 11 / 07 / 2017

PËR

**FILLIMIN E PROCESIT ZGJEDHOR DHE DATËN E ZHVILLIMIT TË ZGJEDHJEVE
JASHTË RADHE, PËR AUTORITETE DREJTUESE NË QENDRËN E STUDIMEVE
ALBANOLOGJIKE**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 131 të Ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Rregullores së Zgjedhjeve Nr. 2459/1, datë 15.03.2016 "Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Fillimin e procesit zgjedhor jashtë radhe, për autoritetet dhe organet drejtuese në Qendrën e Studimeve Albanologjike.
2. Data e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe organet drejtuese, të jetë data 14.08.2017.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Qendra e Studimeve Albanologjike.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MIRELA KARABINA

MINISTËR

